



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1758 Prot.

Roskovec, më 08, 08 2025

V E N D I M

Nr. 12, datë 28 / 02 /2025

“ PËR MIRATIM TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE PËR VITIN 2025 ”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, neni 9 , pika 1.3 , neni 29 dhe neni 54 pika dh , të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 45 , të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44 dhe 45 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM Nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3 paragrafi 3/1, gërma b , Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 77 datë 23.12.2024 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025” si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit; Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI :

1. Të miratohet përdorimi i fondit për objektin : ”Sistemimi i shkarjes në rrugën Buzallarët, Kurjan” në **shumën 3,735,072 lekë** , i cili të përballohet nga Fondi i Kushtëzuar i Emergjencave Civile 2025.

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Vlera e plotë e objektit	2025
1.	17	10910	1	604	Sistemimi i shkarjes në rrugën Buzallarët, Kurjan	3,735,072	3,735,072
SHUMA:						3,735,072	3,735,072

2. Ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

